



**Qendra Ekonomike e
Zhvillimit dhe Edukimit të
Fëmijëve.**

**Këshilla për zhvillimin
konjitiv tek fëmijët
(0-2) vjeç**

**Adresa: Rruga e Barrikadave.
Nr.tel. 042222991**



Këshilla për zhvillimin konjitiv tek fëmijët (0-2) vjeç

0-1 muaj. Foshnja përfshihet në veprime reflektive, si thithja kur i afrohet gjiri/biberoni. Përmes reflekseve, foshnja mëson për mjedisin dhe ndërvepron me të.

1-4 muaj. Foshnja përsërit me qëllim veprimet që i japin kënaqësi, p.sh., një bebe e vogël mund të thithë gishtin, sepse kjo e qetëson. Foshnjat në këtë moshë mund të zhvillojnë pritshmëri për situatat, pra, fillojnë të kuptojnë lidhjen shkak-pasojë. P.sh., një foshnje e kësaj moshe mund të mësojë se, kur sheh një biberon, do të ushqehet shumë shpejt. Nëse foshnja mëson se nevojave të saj (urisë, dhimbjes) do t'i përgjigjen rregullisht, do të mësojë që këto nevoja do t'i plotësohen dhe kështu do të krijojë besim te të rriturit.

4-8 muaj. Foshnjat fillojnë të përsërisin veprime me objektet jashtë trupit të tyre, që iu sjellin kënaqësi dhe gjërat që duan. Foshnjat mësojnë duke i shijuar gjërat, ato përdorin gojën, duart dhe pjesët e tjera të trupit. Foshnja ndjek objektin me sy edhe nëse ai largohet nga fusha e pamjes, kthen kokën ose trupin kur diçka i tërheq vëmendjen, merr informacion për botën dhe bën eksperimente shkak-pasojë, çka ndikon tek forcimi i kujtesës.

8-12 muaj. Foshnjat fillojnë të shfaqin sjellje të qëllimshme, duke kryer disa aktivitete për të arritur një qëllim, pasi kanë mësuar sesi funksionon shkak-pasojë. Foshnjat, tashmë imitojnë atë që shohin tek të tjerët; përsërisin eksperimente me objekte të ndryshme për të parë sesi dallojnë ato nga njëra-tjetra, ato eksperimentojnë duke hedhur objekte të ndryshme për të parë se çfarë po ndodh.

12-18 muaj. Foshnjat vijojnë të eksplorojnë mjedisin dhe të krijojnë eksperimente për të parë sesi funksionojnë gjërat; luajnë me çdo gjë që gjejnë, por ende nuk e kuptojnë se sendet si thikat, prizat elektrike mund t'i dëmtojnë. Për këtë arsye, prindërit dhe kujdestarët duhet të jenë vigilentë dhe ta mbajnë shtëpinë të sigurt. Gjatë kësaj faze, foshnjat kuptojnë se diçka mund të fshihet ose të largohet, por ende ekziston.

18-24 muaj. Foshnjat fillojnë të orientohen nga simbolet, që do të thotë se ata krijojnë një imazh të përgjithshëm të gjërave në mendjen e tyre dhe i ruajnë ato si shembuj të objekteve të ngjashme. Ato mund të krijojnë në mendje imazhin e një arushi me pellush dhe ta përdorin atë për të përfaqësuar lodrat e tjera me pellush. Për këtë arsye, foshnjat mund të kërkojnë për lodrën e tyre të preferuar me pellush në kosh, sepse e dinë se ku ruhet ai, pavarësisht se nuk e kanë parë prindin që e ka vendosur aty. Njohja dhe kujtesa përmirësohen ndjeshëm. Rreth moshës 24 muaj, ata zhvillojnë aftësinë për të imagjinuar gjëra. Duke arritur këtë nivel të menduarit, ata ndërmarrin hapat e parë përtej të menduarit konkret; pra, nuk mendojnë më vetëm për gjërat që janë përpara tyre.

Aktivitete për të stimuluar zhvillimin kognitiv

0-3 muaj

Lexojini foshnjës që në lindje. Tregoji libra me figura me ngjyra të ndezura dhe modele me kontraste të forta. Asaj do t'i pëlqejë të shohë figura dhe të dëgjojë zërin tënd.

Bisedoni me foshnjën. Shihe në sy, buzëqeshi dhe përfshije në bisedë që nga dita e lindjes. Ajo do të dojë të të dëgjojë.

Vendosni një rreth me lodra mbi krevat, ku të varësh lodra me kontraste të forta, të cilat foshnja mund t'i shohë dhe t'i arrijë me lehtësi.

Vendosni pasqyra. Varni një pasqyrë që nuk thyhet tek krevati ose pranë krevatit të ndërrimit, që ajo të shohë fytyrën dhe lëvizjet e saj.

Jepi ni lodra me tinguj të ndryshëm. Foshnja do të mësojë që, duke e goditur lodrën, do dëgjojë një tingull të këndshëm.

Këndoji dhe krijo muzikë. Mos e kufizo veten te muzika e fëmijëve. Ajo do të pëlqejë çdo lloj muzike.

9-12 muaj

Tregojini foshnjës puzzle të thjeshta, por mos u shqetësoni nëse ajo nuk mund t'i bashkojë pjesët.

Bëjini pyetje të thjeshta, si: Ku është hunda jote?

Jepini lodra me lëvizje të ndryshme, që të mësojë konceptet: lart dhe poshtë, majtas dhe djathtas.

Luani lojën e kujtesës, duke përdorur lodrat e foshnjës.

Lexojini foshnjës, përshkruani dhe emërtoni figurat.

12-18 muaj

Tregoji foshnjës **lodra të reja** me të cilat të luajë.

Lexoni libra së bashku dhe **identifikoni** në shtëpi gjërat që i lexoni në libra.

Inkurajojeni të kërcejë dhe të bëjë muzikë me tiganë, shishe, lugë etj.

Tregojini me gisht format dhe ngjyrat kur i flet foshnjës.

Flisni për gjëra, ngjarje dhe njerëz që ajo kujton.

Jepini udhëzime të thjeshta: të kapë/sjellë/të gjejë diçka.

18-24 muaj

Tregojini format, ngjyrat dhe numrat, kur bisedon me foshnjën. dhe **numëroni së bashku,** numëroni gjithçka.

Inkurajojeni të identifikojë zhurmat që dëgjon; **këndoji këngë, kërceni dhe dëgjoni muzikë** së bashku. zikore që foshnja e pëlqen të dëgjojë.

Jepini lirinë të zgjedhë çfarë të veshë, librat që do të lexojë, etj.